



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

KËRKESË PËR OFERTË

Organizata	Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Adresa:	Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
E-mail:	genderjusticealbania@gmail.com
Shërbimi i kërkuar:	Rikonstruktiv i lehtë i godinës së Qendrës Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara
Zona gjeografike e shërbimit të kërkuar:	Bashkia Vlorë
Afati i dorëzimit të ofertës:	28/02/2025

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbrojtjen e drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 15 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. 1738, datë 28/06/2022. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar edhe pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

QDGJSH po zbaton në Bashkinë Vlorë projektin “Ofrimi i shërbimeve të specializuara të kujdesit social për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në Bashkinë Vlorë”, në kuadër të programit “BE për Kujdesin Social”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga UNICEF Shqipëri dhe World Vision Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në kuadër të projektit, QDGJSH po mbështet Bashkinë Vlorë për të ngritur një Qendër Ditore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.

Qendra Ditore do të ngrihet në katin e parë të Qendrës së Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara, me adresë: lagjia: “Pavarësia”, Skelë, Vlorë, godinë për të cilën nevojiten rikonstruktive të lehta si më poshtë:

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

- Patinim dhe lyerje e 5 ambienteve;
- Punime për heqjen e lagështirës në 2 prej ambienteve;
- Rikonstruktivim i tualetit.

1. Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara ftohen që pas inspektimit fizik të ambienteve, të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 28/02/2025, në adresën e e-mailit: genderjusticealbania@gmail.com, fizikisht ose me postë në adresën: Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.

2. Specifikime teknike:

Për këtë projekt, QDGJSH do të zhvillojë procedurën e prokurimit sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi	Sasia/m2	Çmimi/njësi Me TVSH
1	Patinim dhe lyerje		
2	Punime për heqjen e lagështirës		
3	Rikonstruktivim i tualetit		

3. Specifikime të përgjithshme:

Punimet të realizohen në mënyrë cilësore dhe sipas kërkesave të QDGJSH.

Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën 01/03/2025 – 20/03/2025.

4. Procedura e konkurimit:

- 4.1. Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimin e kërkuar;
- 4.2. Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës genderjusticealbania@gmail.com brenda datës 28/02/2025, fizikisht ose me postë në adresën: Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
- 4.3. Paga e subjektit kryhet me transfertë bankare pas ofrimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Në dokumentacionin e dërguar, krahas ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, ofertuesi duhet të paraqesi edhe këto dokumente:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB të marrë deri një ditë para postimit të ofertës;
- 2) Ofertën financiare për çdo shërbim/produkt sipas tabelës më sipër.

Ofertuesi që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas kërkesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

Adena Vangjeli

Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531